

RELACION

SISTEMIMI I JASHTËM

**Zhvillimi i dizajnit te detajuar te
brendshem per zyret e reja te
Qendres per Sherbime Arsimore**

Vendndodhja:
Rruga “Paskal Vodica”;
Kamëz, Tirane, Shqiperi

AUTORITETI KONTRAKTOR:
AADF

ATRIA STUDIO
NR.LIC. N.6853/2
ARK. ENOLA MARTOPULLO

Elma Hoxha
Frosiana Monçi
Leila Deliu
Pamela Hajdëraj

Permbajtja

1	Të dhëna të përgjithshme.....	3
1.1	Objekti i projektit	3
2	Analiza e gjendjes ekzistuese	4
2.1	Konfigurimi i hapësirës	4
2.2	Morfologjia dhe kuotat e terrenit.....	5
2.3	Akseset dhe qarkullimi	7
2.3.1	Aksesi.....	7
2.3.2	Qarkullimi	8
2.4	Gjelbërimi ekzistues	8
2.5	Vlerësimi i gjendjes ekzistuese.....	9
2.6	Mundesite e zhvillimit të hapësirës	10
3	Parimet e projektimit.....	11
3.1	Parimet funksionale dhe hapësinore	11
3.2	Parimet arkitektonike dhe peizazhistike	11
3.3	Parimet funksionale, teknike dhe mjedisore.....	11
4	Koncepti arkitektonik	11
4.1	Ideja kryesore	11
4.2	Kompozimi arkitektonik.....	12
4.3	Marrëdhënia me arkitekturën e godinës	14
4.4	Marrëdhënia ndërmjet arkitekturës dhe peizazhit.....	14
5	Zgjidhja arkitektonike.....	15
5.1	Modelimi arkitektonik i terrenit	15
5.2	Organizimi funksional i hapësirës	15
5.3	Parametrat kryesor teknik.....	16
5.4	Hapësirat e qëndrimit dhe aktivitetit.....	18
5.5	Sistemi i qarkullimit dhe lidhjet vertikale.....	19
6	Përmbledhje.....	24

1 Të dhëna të përgjithshme

1.1 Objekti i projektit

Objekti i projektit përfshin trajtimin arkitektonik të sistemimit të jashtëm të oborrit të brendshëm të Qendrës për Shërbime Arsimore, si dhe të hapësirave lidhëse që mbështesin funksionimin e tij në raport me godinën. Ndërhyrja trajton organizimin hapësinor dhe funksional të oborrit, modelimin e terrenit, sistemimin e platformave, shkallëve dhe rampave, përcaktimin e zonave të qarkullimit, qëndrimit dhe aktiviteteve, si dhe integrimin arkitektonik të gjelbërimit, elementeve ujore, mobilimit të jashtëm, ndriçimit dhe sinjalistikës.

Projekti synon krijimin e një hapësire të jashtme të unifikuar, funksionale dhe të aksesueshme, e cila lidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë me hyrjet dhe funksionet e godinës dhe shërben si vazhdimësi e konceptit të saj arkitektonik. Zgjidhja e propozuar përcakton karakterin, organizimin dhe trajtimin arkitektonik të hapësirës, ndërsa aspektet e dimensionimit dhe zgjidhjeve teknike të disiplinave të tjera trajtohen në projektet dhe relacionet përkatëse.

1.2 Vendndodhja dhe konteksti

Objekti i ndërhyrjes ndodhet në Bashkinë Kamëz, brenda kampusit të Universitetit Bujqësor të Tiranës, përgjatë rrugës “Paskal Vodica”. Pozicioni i tij në pjesën veriore të zonës urbane të Tiranës mundëson akses nëpërmjet rrjetit rrugor ekzistues dhe linjave të transportit publik që lidhin Tiranën me Kamzën dhe zonat përreth.

Hapësira që trajtohet nga projekti zhvillohet kryesisht në oborrin e brendshëm të godinës dhe në zonat e jashtme që sigurojnë lidhjen e saj me hyrjet, daljet dhe ambientet funksionale të objektit. Oborri formohet nga volumet rrethuese të godinës dhe ka karakterin e një hapësire të mbrojtur, të orientuar drejt brendësisë së kompleksit.

Pozicionimi qendror i oborrit krijon një marrëdhënie të drejtpërdrejtë ndërmjet hapësirave të brendshme dhe atyre të jashtme. Në nivelin e katit përdhes, ai lidhet me recepsionin, zonat e pritjes dhe ambientet e testimit digjital, duke shërbyer si hapësirë kalimi, orientimi dhe qëndrimi për kandidatët, vizitorët dhe personelin. Lidhja me këto funksione e bën oborrin pjesë të rëndësishme të organizimit të përgjithshëm të godinës dhe jo një sipërfaqe të jashtme të shkëputur prej saj.

Konfigurimi i mbyllur i hapësirës, diferencat e kuotave të terrenit, marrëdhënia me hyrjet dhe daljet e godinës, si dhe nevoja për të ruajtur qarkullimin funksional dhe të sigurt, përbëjnë elementet kryesore të kontekstit mbi të cilat është mbështetur zgjidhja arkitektonike.

1.3 Qëllimi i projektit

Qëllimi i projektit është rikualifikimi arkitektonik i hapësirave të jashtme të objektit, duke krijuar një mjedis funksional, të aksesueshëm, të sigurt dhe estetikisht të integruar me arkitekturën ekzistuese të godinës.

Projekti synon përmirësimin e organizimit hapësinor të oborrit dhe zonave lidhëse, rritjen e cilësisë së përdorimit të tyre dhe krijimin e një identiteti të qartë arkitektonik, në përputhje me funksionin institucional të objektit dhe kërkesat e përcaktuara në Termat e Referencës.

Zgjidhjet e propozuara janë zhvilluar mbi bazën e analizës së gjendjes ekzistuese dhe objektivave funksionale të projektit, me synimin për të krijuar një hapësirë të jashtme të qëndrueshme, fleksibël dhe të përshtatshme për nevojat aktuale dhe afatgjata të institucionit.

1.4 Baza dokumentare dhe normative

Hartimi i projektit arkitektonik është mbështetur në dokumentacionin teknik dhe administrativ të vënë në dispozicion nga Autoriteti Kontraktor, si dhe në verifikimet dhe analizat e kryera gjatë fazës së studimit të gjendjes ekzistuese. Dokumentacioni bazë përfshin Termat e Referencës të procedurës së prokurimit, dokumentacionin grafik të objektit, të dhënat topografike dhe informacionin teknik të nevojshëm për zhvillimin e projektit.

Projekti është hartuar në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi në fushën e planifikimit, projektimit dhe ndërtimit, si dhe duke respektuar standardet dhe normat teknike që lidhen me projektimin e hapësirave të jashtme, aksesueshmërinë për personat me aftësi të kufizuara, sigurinë në përdorim dhe kërkesat funksionale të objekteve publike.

Për aspektet teknike që lidhen me disiplinat konstruktive, hidraulike, elektrike, mekanike dhe sistemet e tjera inxhinierike, projekti mbështetet në koordinimin ndërdisiplinor me projektet përkatëse, të cilat zhvillohen dhe dokumentohen në relacionet e tyre specifike.

2 Analiza e gjendjes ekzistuese

Analiza e gjendjes ekzistuese është zhvilluar mbi bazën e dokumentacionit teknik të vënë në dispozicion nga Autoriteti Kontraktor, të dhënave topografike, materialit grafik ekzistues, si dhe verifikimeve dhe rievimeve të kryera në terren nga grupi i projektimit. Këto verifikime kanë bërë të mundur evidentimin e karakteristikave fizike dhe funksionale të hapësirës, marrëdhënies së saj me godinën, elementeve ekzistuese të sistemit, konfigurimit të terrenit, aksesit dhe problematikave që ndikojnë në organizimin e përgjithshëm të ndërhyrjes.

Analiza e paraqitur në këtë kapitull përbën bazën mbi të cilën është zhvilluar koncepti arkitektonik dhe janë formuluar zgjidhjet e propozuara në kapitujt vijues.

2.1 Konfigurimi i hapësirës

Hapësira objekt ndërhyrjeje zhvillohet në oborrin e brendshëm të godinës, i cili organizohet si një hapësirë qendrore e rrethuar nga volumet e ndërtimit në të katër anët. Për shkak të pozicionit dhe rolit të tij në organizimin e objektit, ky oborr funksionon si atriumi hapur i godinës, duke krijuar qendrën e organizimit hapësinor dhe funksional të saj.

Atriumi krijon lidhje të drejtpërdrejta me hyrjet dhe ambientet kryesore të katit përdhes, duke siguruar vazhdimësinë ndërmjet hapësirave të brendshme dhe atyre të jashtme. Përveç funksionit të qarkullimit, ai përbën edhe pikën kryesore të orientimit dhe shpërndarjes së përdoruesve brenda kompleksit.



Figura 1 Pamje nga brenda

Nga analiza e gjendjes ekzistuese rezulton se, megjithëse konfigurimi arkitektonik i oborrit krijon një potencial të rëndësishëm për organizimin e aktiviteteve të jashtme, hapësira aktualisht nuk paraqet një organizim të unifikuar funksional dhe kompozicional. Diferencat e kuotave, platformat e fragmentuara dhe elementet ekzistuese të sistemit krijojnë zona të shkëputura nga njëra-tjetra, duke kufizuar përdorimin efikas të oborrit dhe vazhdimësinë e lëvizjes së përdoruesve.

Konfigurimi qendror i atriumit përfaqëson potencialin kryesor të projektit, pasi krijon mundësinë që hapësira e jashtme të organizohet si një sistem i integruar qarkullimi, qëndrimi dhe ndërveprimi, në harmoni me arkitekturën dhe funksionin institucional të godinës.

2.2 Morfologjia dhe kuotat e terrenit

Relievi i parcelës karakterizohet nga diferenca të konsiderueshme kuotash, të cilat kanë ndikuar drejtpërdrejt në mënyrën e organizimit të godinës dhe të hapësirave të jashtme. Hyrja kryesore zhvillohet në kuotën referuese +70.45, ndërsa hapësira qendrore e oborrit zbret gradualisht deri në kuotën +67.75, duke krijuar një diferencë altimetrike prej rreth 2.70 m.

Kjo marrëdhënie ndërmjet kuotave të rrugëve perimetrale dhe hapësirës qendrore ka përcaktuar organizimin morfologjik të oborrit. Ndryshimet e nivelit janë trajtuar nëpërmjet platformave, shkallëve dhe mureve mbajtëse, të cilat sigurojnë lidhjen ndërmjet niveleve të ndryshme dhe stabilitetin e terrenit.




Figura 2 Terreni ekzistues i sistemimit

Nga analiza e gjendjes ekzistuese konstatohet se organizimi aktual i relievit është zhvilluar kryesisht si përgjigje ndaj karakteristikave topografike të parcelës dhe nevojave funksionale të objektit. Megjithatë elementet ekzistuese mundësojnë përdorimin e hapësirës, platformat paraqiten të fragmentuara dhe lidhjet vertikale mbështeten kryesisht në shkallë, duke kufizuar vazhdimësinë e qarkullimit dhe aksesueshmërinë ndërmjet niveleve.

Një karakteristikë e rëndësishme e objektit është mënyra se si organizimi arkitektonik i godinës është zhvilluar në përshtatje me morfologjinë ekzistuese të terrenit. Hyrjet kryesore janë vendosur në kuotën e rrugëve perimetrale, ndërsa hapësira qendrore e oborrit zhvillohet në nivele më të ulëta, duke krijuar një marrëdhënie të drejtpërdrejtë ndërmjet arkitekturës dhe topografisë së sitit. Ky organizim i jep atriumit rolin e një hapësire qendrore që lidh funksionalisht volumet e godinës, ndërsa ndryshimet e kuotave bëhen pjesë e identitetit hapësinor të kompleksit dhe përcaktojnë mënyrën e përdorimit dhe perceptimit të tij.

Morfologjia e terrenit përbën një nga karakteristikat kryesore të sitit dhe njëkohësisht elementin bazë mbi të cilin mbështetet organizimi i hapësirës së jashtme. Për këtë arsye, analiza e relievit dhe e marrëdhënies së tij me godinën përbën pikënisjen për zhvillimin e konceptit arkitektonik të ndërhyrjes.

2.3 Akseset dhe qarkullimi

2.3.1 Aksesit

Aksesi në objektin subjekt të kësaj ndërhyrje organizohet në funksion të konfigurimit topografik të parcelës dhe të marrëdhënies së godinës me rrugët që e rrethojnë. Hyrja kryesore në hapësirën e jashtme realizohet nëpërmjet katit përdhe të godinës, në nivelin ku ndodhet recepsioni. Ky nivel përkton me kuotën e hyrjes kryesore të objektit dhe përbën pikën kryesore të shpërndarjes së përdoruesve drejt atriumit.

Në anën perëndimore të parcelës, atriumi lidhet drejtpërdrejt me rrugën publike nëpërmjet një pasazhi ekzistues, i cili përfaqëson lidhjen kryesore të niveleve të ulëta të hapësirës së jashtme me mjedisin urban përreth.



Figura 3 Gjendja ekzistuese

Në këtë pasazh është vendosur një hyrje që shërben për komunikimin me katet e sipërme të godinës. Analiza e gjendjes ekzistuese tregon se kjo hyrje paraqet probleme funksionale, pasi pragu i derës i cili përkton edhe me kuotën e dyshemësë së këtij kati, ndodhet rreth 50 cm më poshtë se kuota e sistemit ekzistues, duke krijuar një diferencë niveli që e vështirëson përdorimin e saj dhe kufizon aksesin e drejtpërdrejtë.

Në anën lindore ndodhet një pasazh i dytë. Megjithatë parcela kufizohet edhe me një rrugë edhe në këtë anë, lidhja me të nuk realizohet në mënyrë funksionale. Diferenca e kuotave është trajtuar me një sipërfaqe të gjelbër me pjerrësi, e cila siguron vazhdimësinë e relievit, por nuk krijon kushte të përshtatshme për lëvizjen e këmbësorëve dhe nuk mund të konsiderohet një pikë efektive aksesit në kompleks.



Figura 4 Gjëlberimi ekzistues

2.3.2 Qarkullimi

Organizimi i qarkullimit këmbësor zhvillohet në funksion të konfigurimit morfologjik të atriumit dhe shpërndarjes së hyrjeve të godinës. Lëvizja ndërmjet niveleve realizohet kryesisht nëpërmjet shkallëve dhe platformave ekzistuese, të cilat ndjekin ndryshimet altimetrike të terrenit dhe mundësojnë lidhjen ndërmjet hyrjes kryesore, pasazhit perëndimor dhe hapësirave të tjera të jashtme.

Megjithëse sistemi ekzistues siguron funksionalitetin bazë të hapësirës, ai nuk krijon një rrjet qarkullimi të vazhdueshëm dhe plotësisht të aksesueshëm. Lidhjet vertikale mbështeten pothuajse tërësisht në shkallë, ndërsa diferencat e konsiderueshme të kuotave kufizojnë lëvizjen e personave me aftësi të

kufizuara, përdoruesve të karrocave për fëmijë dhe personave me vështirësi në lëvizje.

Në tërësi, analiza e gjendjes ekzistuese evidenton se organizimi i aksesit dhe i qarkullimit është i kushtëzuar nga konfigurimi topografik i parcelës dhe nga mënyra e zhvillimit të godinës në raport me të. Këto karakteristika përbëjnë bazën për vlerësimin e ndërhyrjeve të nevojshme, me synim përmirësimin e aksesueshmërisë, funksionalitetit dhe lidhjes së hapësirës së jashtme me rrjetin urban përreth.

2.4 Gjëlberimi ekzistues

Hapësira e jashtme karakterizohet nga prania e sipërfaqeve të gjëlberuara me bar. Gjëlberimi ekzistues ka karakter kryesisht funksional, duke shërbyer si trajtim i sipërfaqeve të lira ndërmjet platformave dhe elementeve ndërtimore.

Analiza e gjendjes ekzistuese evidenton se gjëlberimi nuk është organizuar si një sistem peizazhistik me funksione rekreative apo orientuese. Në hapësirën e trajtuar mungojnë pemët, shkurret dekorative dhe elemente të tjera të gjëlberimit që mund të krijojnë hijezim, strukturë hapësinore ose zona të mirëpërcaktuara qëndrimi. Për pasojë, gjëlberimi ekzistues ka një rol të kufizuar në formësimin e identitetit të hapësirës së jashtme.

Megjithëse sipërfaqet e gjëlberuara kontribuojnë në përmirësimin e pamjes së përgjithshme të kompleksit dhe në reduktimin e sipërfaqeve të ngurta, organizimi i tyre paraqet potencial për një trajtim më të integruar, në përputhje me funksionin dhe karakterin arkitektonik të atriumit.



Figura 5 Gjelberimi ekzistues

2.5 Vlerësimi i gjendjes ekzistuese

Analiza e gjendjes ekzistuese evidenton se hapësira e jashtme është zhvilluar kryesisht si rezultat i nevojave funksionale të objektit, pa u mbështetur në një koncept të unifikuar arkitektonik dhe peizazhistik. Si pasojë, organizimi aktual nuk arrin të shfrytëzojë plotësisht potencialin që ofron atriumi si hapësira qendrore organizuese e godinës.

Konfigurimi morfologjik i terrenit, megjithëse përbën një karakteristikë të rëndësishme të sitit, është trajtuar kryesisht nëpërmjet zgjidhjeve teknike për kapërcimin e diferencave të kuotave, pa i integruar ato në një organizim të qartë kompozicional dhe funksional. Platformat, shkallët dhe elementet mbështetëse sigurojnë lidhjen bazë ndërmjet niveleve, por nuk krijojnë një sistem të vazhdueshëm qarkullimi dhe nuk garantojnë aksesueshmëri të plotë për të gjithë përdoruesit.

Organizimi i hapësirës nuk përcakton qartë hierarkinë e lëvizjes, zonat e qëndrimit dhe marrëdhënien ndërmjet funksioneve të ndryshme të godinës. Atriumi shfrytëzohet kryesisht si hapësirë kalimi, ndërsa mungojnë ambiente të mirëpërcaktuara për qëndrim, socializim apo zhvillimin e aktiviteteve në hapësirën e jashtme.

Nga pikëpamja peizazhistike, vegetacioni ekzistues ka karakter spontan dhe nuk është pjesë e një organizimi të strukturuar. Gjithashtu, në hapësirë mungojnë elementet e mobilimit urban, ndriçimi funksional dhe dekorativ, si dhe elemente të tjera arkitektonike që do të kontribuonin në përmirësimin e cilësisë së përdorimit dhe të identitetit të saj.

Në tërësi, analiza evidenton një integrim të kufizuar ndërmjet konfigurimit të terrenit, organizimit të hapësirës së jashtme dhe arkitekturës së godinës. Këto karakteristika krijojnë nevojën për një ndërhyrje të integruar arkitektonike, e cila të përmirësojë funksionalitetin, aksesueshmërinë, cilësinë hapësinore dhe marrëdhënien e atriumit me objektin dhe mjedisin përreth.

Pavarësisht këtyre kufizimeve, konfigurimi qendror i atriumit, marrëdhënia e tij me hyrjet e godinës dhe karakteristikat morfologjike të terrenit përbëjnë bazën mbi të cilën mund të zhvillohet një organizim i ri arkitektonik, më funksional dhe më koherent.

2.6 Mundësitë e zhvillimit të hapësirës

Pavarësisht kufizimeve të evidentuara në organizimin aktual, hapësira paraqet potencial të konsiderueshëm për zhvillimin e një mjedisi të jashtëm me cilësi të lartë arkitektonike dhe funksionale. Pozicioni qendror i atriumit në raport me godinën dhe lidhja e tij me funksionet kryesore të katit përdhe e bëjnë atë elementin organizues të hapësirave të jashtme dhe pikën kryesore të orientimit dhe shpërndarjes së përdoruesve.

Konfigurimi morfologjik i terrenit dhe diferencat natyrore të kuotave përfaqësojnë një potencial të rëndësishëm për organizimin e hapësirës në nivele të ndryshme, duke krijuar mundësi për një kompozim arkitektonik më të pasur dhe për një përdorim më efikas të relievit ekzistues. Në të njëjtën kohë, marrëdhënia ndërmjet godinës, atriumit dhe rrugëve përreth ofron mundësi për përmirësimin e aksesit, të qarkullimit dhe të lidhjeve funksionale me mjedisin urban.

Potencial zhvillimi paraqet gjithashtu edhe organizimi i hapësirave të lira, të cilat mund të strukturohen në mënyrë më të qartë dhe të mbështesin funksione të ndryshme, si qëndrimi, ndërveprimi social, orientimi dhe zhvillimi i aktiviteteve në ambient të hapur. Njëkohësisht, sipërfaqet e gjelbëruara ofrojnë mundësi për një trajtim peizazhistik më të integruar, në përputhje me karakterin institucional të objektit dhe me organizimin arkitektonik të kompleksit.

Në tërësi, karakteristikat fizike, funksionale dhe hapësinore të sitit krijojnë premisa të favorshme për zhvillimin e një koncepti të unifikuar të sistemit të jashtëm, i cili forcon marrëdhënien ndërmjet arkitekturës, topografisë dhe peizazhit, duke përmirësuar cilësinë e përdorimit dhe identitetin e hapësirës.

Mundësitë e zhvillimit të hapësirës:

- Shfrytëzimi i relievit natyror dhe i diferencave të kuotave si element kompozicional.
- Krijimi i një sistemi platformash, shkallësh dhe rampash që organizojnë lëvizjen dhe qëndrimin.
- Integrimi funksional dhe vizual i oborrit me arkitekturën e godinës.
- Krijimi i hapësirave për pushim, socializim, aktivitete rekreative dhe zhvillim të aktiviteteve në natyrë.
- Riorganizimi i gjelbërimit dhe pasurimi i hapësirës me pemë, shkurre dekorative dhe elemente hijezuese.
- Integrimi i elementeve të ujit, mobilimit urban dhe ndriçimit peizazhistik.
- Përmirësimi i identitetit estetik dhe karakterit peizazhistik të oborrit.
- Krijimi i një hapësire publike të aksesueshme, funksionale dhe të qëndrueshme, që shërben si vazhdimësi e ambienteve të brendshme të godinës.

3 Parimet e projektimit

3.1 Parimet funksionale dhe hapësinore

Projektimi i sistemit të jashtëm është orientuar drejt krijimit të një hapësire funksionale, të organizuar dhe lehtësisht të përdorshme, e cila mbështet aktivitetin e përditshëm të godinës dhe përmirëson marrëdhënien ndërmjet ambienteve të brendshme dhe atyre të jashtme. Organizimi i hapësirës synon të krijojë një strukturë të qartë funksionale, në të cilën qarkullimi, zonat e qëndrimit dhe hapësirat për aktivitete të ndërthuren në mënyrë harmonike dhe të funksionojnë si pjesë e një sistemi të unifikuar. Në të njëjtën kohë, projektimi udhëhiqet nga parimi i krijimit të një hierarkie të qartë hapësinore, që lehtëson orientimin e përdoruesve, garanton vazhdimësinë e lëvizjes dhe mundëson përdorim fleksibël të hapësirës në përputhje me funksionin institucional të objektit.

3.2 Parimet arkitektonike dhe peizazhistike

Projektimi arkitektonik synon krijimin e një hapësire të jashtme me identitet të qartë, e cila harmonizohet me karakterin arkitektonik të godinës dhe kontribuon në përmirësimin e cilësisë së përgjithshme të kompleksit. Organizimi i elementeve të sistemit, përzgjedhja e materialeve, trajtimi i gjelbërimit dhe integrimi i mobilimit urban do të konceptohen si pjesë të një kompozimi të vetëm arkitektonik, ku secili element kontribuon në krijimin e një tërësie koherente dhe funksionale. Gjelbërimi do të trajtohet si element strukturues i hapësirës dhe jo vetëm si komponent dekorativ, ndërsa elementet arkitektonike dhe peizazhistike synojnë të krijojnë një mjedis me cilësi të lartë estetike, të përshtatshëm për funksionin publik të objektit dhe të integruar në mënyrë harmonike me mjedisin përreth.

3.3 Parimet funksionale, teknike dhe mjedisore

Procesi i projektimit zhvillohet duke respektuar parimet e aksesueshmërisë universale, sigurisë në përdorim dhe organizimit të qartë të qarkullimit këmbësor, me qëllim krijimin e një hapësire të përdorshme nga të gjithë përdoruesit. Zgjidhjet arkitektonike synojnë të orientohen drejt përshtatjes me konfigurimin ekzistues të terrenit, duke shfrytëzuar karakteristikat morfologjike të sitit dhe duke kufizuar ndërhyrjet e panevojshme në reliev. Njëkohësisht, projektimi mbështetet në parimet e qëndrueshmërisë mjedisore, nëpërmjet përzgjedhjes së materialeve me jetëgjatësi të lartë dhe kërkesa të reduktuara për mirëmbajtje, përdorimit të specieve bimore të përshtatura me kushtet klimatike të zonës dhe integritetit të zgjidhjeve që kontribuojnë në përmirësimin e mikroklimës dhe të cilësisë së hapësirës së jashtme. Të gjitha zgjidhjet janë konceptuar në mënyrë të koordinuar me disiplinat e tjera të projektimit, duke garantuar funksionalitet, qëndrueshmëri dhe lehtësi mirëmbajtjeje gjatë gjithë ciklit të përdorimit të objektit.

4 Koncepti arkitektonik

4.1 Ideja kryesore

Koncepti arkitektonik i projektit është zhvilluar duke marrë si pikënisje karakteristikat morfologjike të sitit dhe marrëdhënien e oborrit me volumet e godinës ekzistuese. Në vend që relievi të konsiderohej një kufizim për organizimin e hapësirës, ai është trajtuar si elementi

kryesor gjenerues i kompozimit arkitektonik. Diferencat ekzistuese të kuotave janë shfrytëzuar për të organizuar hapësirën në nivele të ndryshme, duke krijuar një sistem të integruar qarkullimi, qëndrimi dhe aktiviteteve, i cili forcon lidhjen ndërmjet ambienteve të brendshme dhe atyre të jashtme. Në këtë mënyrë, oborri transformohet nga një hapësirë me funksion kryesisht kalimtar në një mjedis aktiv, fleksibël dhe përfaqësues, në përputhje me karakterin institucional të objektit.

4.2 Kompozimi arkitektonik

Kompozimi arkitektonik i sistemimit të jashtëm është zhvilluar duke marrë si pikënisje karakteristikat morfologjike të sitit dhe marrëdhënien e tij me arkitekturën e godinës ekzistuese. Relievi nuk është trajtuar si një kufizim teknik që duhej korrigjuar, por si elementi kryesor gjenerues i projektit, mbi të cilin është ndërtuar organizimi hapësinor dhe funksional i ndërhyrjes. Kjo qasje ka mundësuar zhvillimin e një kompozimi që përshtatet natyrshëm me konfigurimin ekzistues të terrenit, duke minimizuar ndërhyrjet e panevojshme dhe duke ruajtur karakterin e sitit.

Parimi themelor i organizimit bazohet në krijimin e një sistemi platformash të zhvilluara në nivele të ndryshme, të cilat ndjekin ndryshimet ekzistuese të kuotave dhe krijojnë një organizim të qartë të funksioneve. Platformat nuk janë konceptuar si elemente të veçuara, por si pjesë të një sistemi të vazhdueshëm që organizon qarkullimin, zonat e qëndrimit, hapësirat e ndërveprimit dhe elementet e gjelbërimit. Diferencat altimetrike shfrytëzohen për të krijuar një hierarki natyrore të hapësirave, duke i dhënë secilës zonë një karakter dhe një rol të veçantë në organizimin e përgjithshëm të oborrit.

Kompozimi mbështetet në një gjeometri të pastër dhe të kontrolluar, e cila krijon një gjuhë arkitektonike bashkëkohore dhe lehtësisht të lexueshme. Organizimi i planeve horizontale, drejtimet e qarkullimit dhe marrëdhënia ndërmjet sipërfaqeve të ndërtuara dhe atyre të gjelbëruara krijojnë një ritëm të vazhdueshëm kompozicional, duke shmangur fragmentimin e hapësirës dhe duke forcuar perceptimin e saj si një tërësi e unifikuar. Raporti ndërmjet elementeve të forta dhe atyre natyrore është trajtuar me kujdes, me qëllim arritjen e një ekuilibri ndërmjet karakterit urban të ndërhyrjes dhe cilësive peizazhistike të saj.

Gjeometria kompozicionale nuk kufizohet vetëm në trajtimin e sipërfaqeve të shtruara, por përbën matricën organizuese të të gjithë sistemimit. Rrjeti i linjave diagonale dhe formave poligonale gjeneron organizimin e platformave, pozicionimin e shkallëve, shpërndarjen e hapësirave të gjelbëruara, integrimin e elementeve ujore dhe drejtimet kryesore të lëvizjes. Në këtë mënyrë, forma dhe funksioni zhvillohen në mënyrë të pandashme, duke krijuar një kompozim koherent në të cilin çdo element është pjesë e së njëjtës logjikë projektuese.

Një tjetër parim i rëndësishëm i kompozimit është krijimi i një hierarkie të qartë të hapësirave. Zonat kryesore të qarkullimit dhe aktiviteteve organizohen si elementet dominuese të projektit, ndërsa hapësirat e qëndrimit dhe zonat më të qeta vendosen në marrëdhënie të drejtpërdrejta me gjelbërimin dhe elementet peizazhistike. Kjo organizim krijon një tranzicion gradual ndërmjet hapësirave me karakter më publik dhe atyre me karakter më intim, duke mundësuar përdorime të ndryshme pa cenuar unitetin e kompozimit.

Lëvizja e përdoruesit përbën një element aktiv të konceptit kompozicional. Boshtet kryesore të qarkullimit nuk synojnë vetëm lidhjen funksionale të hyrjeve dhe niveleve të ndryshme të

terenit, por ndërtojnë një sekuençë të vazhdueshme perceptimi të hapësirës. Ndryshimet e kuotave, alternimi i zonave të hapura me ato të gjelbëruara dhe orientimi i pamjeve krijojnë një përvojë dinamike, ku përdoruesi zbulon gradualisht karakteristikat e oborrit gjatë lëvizjes. Kjo mënyrë organizimi shmanget perceptimin statik të hapësirës dhe krijon një marrëdhënie më aktive ndërmjet përdoruesit dhe mjedisit të ndërtuar.

Elementet funksionale të projektit janë trajtuar si pjesë përbërëse e kompozimit arkitektonik. Shkallët, rampat, muret mbajtëse, bordurat, ulëset dhe elementet e mobilimit urban nuk kanë vetëm rol teknik, por kontribuojnë në strukturimin e hapësirës, në orientimin e përdoruesve dhe në krijimin e identitetit të ndërhyrjes. Çdo element është konceptuar për të marrë pjesë në organizimin e tërësisë, duke krijuar një gjuhë të përbashkët arkitektonike dhe një vazhdimësi ndërmjet funksionit dhe formës.

Kompozimi synon gjithashtu të forcojë marrëdhënien ndërmjet arkitekturës së godinës dhe hapësirës së jashtme. Organizimi i platformave, drejtimet kryesore të lëvizjes, ritmi i elementeve të sistemimit dhe trajtimi i materialeve krijojnë një vazhdimësi vizuale dhe funksionale me objektin ekzistues, duke e bërë oborrin pjesë të pandashme të përvojës arkitektonike të kompleksit. Në këtë mënyrë, sistemimi i jashtëm nuk perceptohet si një ndërhyrje e pavarur, por si zgjerim natyror i arkitekturës së godinës.

Në tërësi, parimet kompozicionale synojnë krijimin e një hapësire të jashtme të balancuar, të lexueshme dhe me identitet të qartë arkitektonik, ku relievi, qarkullimi, gjelbërimi, materialet




Figura 6 Plani i elementeve që do të hiqen

dhe elementet e sistemimit ndërthuren në një kompozim të vetëm, të aftë të përmbushë njëkohësisht kërkesat funksionale, estetike dhe peizazhistike të projektit.

4.3 Marrëdhënia me arkitekturën e godinës

Koncepti i sistemimit të jashtëm është zhvilluar në marrëdhënie të drejtpërdrejtë me arkitekturën e godinës, duke e trajtuar oborrin si një vazhdimësi funksionale dhe kompozicionale të saj. Organizimi i hapësirës nuk synon të krijojë një element të pavarur, por të plotësojë dhe të forcojë karakterin arkitektonik të objektit, duke krijuar një dialog të vazhdueshëm ndërmjet ambienteve të brendshme dhe atyre të jashtme.

Pozicionimi i platformave, organizimi i qarkullimit dhe vendosja e hapësirave të qëndrimit janë zhvilluar në funksion të hyrjeve ekzistuese dhe të mënyrës së përdorimit të godinës, duke mundësuar një lidhje të natyrshme ndërmjet funksioneve të brendshme dhe aktiviteteve që zhvillohen në ambientin e jashtëm. Në këtë mënyrë, oborri nuk perceptohet si një hapësirë dytësore, por si pjesë përbërëse e organizimit të përgjithshëm të kompleksit.

Përzgjedhja e materialeve, trajtimi i elementeve ndërtimore dhe gjuha formale e sistemimit janë orientuar drejt krijimit të një identiteti të përbashkët me arkitekturën ekzistuese, duke ruajtur një ekuilibër ndërmjet respektimit të karakterit të godinës dhe shprehjes bashkëkohore të ndërhyrjes. Ritmi i elementeve të sistemimit, marrëdhënia ndërmjet sipërfaqeve të forta dhe atyre të gjelbëruara, si dhe organizimi i boshllëqeve dhe i planeve horizontale synojnë të krijojnë një vazhdimësi vizuale që e lidh oborrin me arkitekturën e objektit.

Në tërësi, ndërhyrja është konceptuar në mënyrë që sistemi i hapësirave të jashtme të funksionojë si një zgjerim natyror i godinës, duke rritur cilësinë funksionale dhe arkitektonike të saj dhe duke forcuar identitetin e kompleksit si një tërësi e unifikuar.

4.4 Marrëdhënia ndërmjet arkitekturës dhe peizazhit

Në këtë projekt, peizazhi nuk trajtohet si një element dekorativ i shtuar pas organizimit të hapësirës, por si pjesë përbërëse e konceptit arkitektonik. Organizimi i terrenit, gjelbërimit, elementeve ujore dhe mobilimit urban është zhvilluar në mënyrë të integruar me sistemin e platformave dhe të qarkullimit, duke krijuar një kompozim të vetëm, ku elementët natyrorë dhe ata të ndërtuar plotësojnë dhe forcojnë njëri-tjetrin.

Konfigurimi ekzistues i terrenit përbën bazën e këtij organizimi, ndërsa ndërhyrjet e propozuara synojnë ta interpretojnë relievin si pjesë të përvojës hapësinore. Diferencat e kuotave, të cilat aktualisht përfaqësojnë një karakteristikë fizike të sitit, transformohen në elemente që strukturojnë lëvizjen, përcaktojnë zonat funksionale dhe krijojnë marrëdhënie të ndryshme vizuale ndërmjet pjesëve të oborrit.

Gjelbërimi është konceptuar si element strukturues i hapësirës, me funksion organizues, mjedisor dhe estetik. Përveç rolit të tij në krijimin e hijëzimit dhe përmirësimin e mikroklimës, ai kontribuon në përcaktimin e kufijve të hapësirave, në orientimin e përdoruesve dhe në zbutjen e karakterit mineral të sipërfaqeve të shtruara. Në këtë mënyrë krijohet një ekuilibër ndërmjet sipërfaqeve të ndërtuara dhe elementeve natyrore, duke rritur cilësinë e përgjithshme të mjedisit.

Elementet ujore dhe mobilimi urban integrohen në të njëjtën logjikë kompozicionale, duke u trajtuar si pjesë e organizimit të përgjithshëm dhe jo si elemente të pavarura. Pozicionimi, forma dhe materialiteti i tyre janë përcaktuar në funksion të strukturës së hapësirës dhe të marrëdhënieve që krijohen ndërmjet platformave, gjelbërimit dhe akseve të lëvizjes, duke kontribuar në krijimin e një identiteti të dallueshëm arkitektonik dhe peizazhistik.

Në tërësi, marrëdhënia ndërmjet arkitekturës dhe peizazhit mbështetet në parimin e integritetit të të gjitha elementeve të sistemit në një tërësi koherente, ku funksioni, forma, materiali dhe natyra bashkëveprojnë për të krijuar një hapësirë të jashtme me cilësi të lartë arkitektonike, mjedisore dhe funksionale.

5 Zgjidhja arkitektonike

5.1 Modelimi arkitektonik i terrenit

Modelimi arkitektonik i terrenit përbën bazën e organizimit hapësinor të projektit dhe zhvillohet nëpërmjet një ndërhyrjeje që interpreton relievin ekzistues si pjesë të kompozimit arkitektonik. Në vend që diferencat e kuotave të trajtohen si kufizime të sitit, ato janë integruar në konceptin e sistemit, duke gjeneruar një organizim të ri të hapësirës që respekton karakteristikat morfologjike të oborrit dhe minimizon ndërhyrjet në konfigurimin natyror të terrenit.

Zgjidhja bazohet në krijimin e një sistemi platformash të tarracuara, të cilat zhvillohen në nivele të ndryshme dhe ndërthuren me shkallë, rampa, mure mbajtëse dhe sipërfaqe të gjelbëruara, duke formuar një topografi të re arkitektonike brenda atriumit. Ky modelim nuk synon vetëm zgjidhjen e diferencave altimetrike, por organizon funksionet, përcakton drejtimet e lëvizjes dhe krijon një hierarki të qartë të hapësirave.

Ndryshimi gradual i niveleve krijon një tranzicion natyror ndërmjet pjesëve të ndryshme të atriumit, duke mundësuar kalimin e vazhdueshëm nga zonat e hyrjes drejt nivelit qendror dhe hapësirës multifunkionale në kuotën më të ulët. Në të njëjtën kohë, modelimi i terrenit gjeneron ambiente me karaktere të ndryshme, të përshtatshme për qarkullim, qëndrim, pushim dhe zhvillimin e aktiviteteve në ambient të hapur, duke i dhënë secilit nivel një rol të veçantë në organizimin e përgjithshëm të projektit.

Modelimi arkitektonik i terrenit kontribuon gjithashtu në krijimin e marrëdhënieve të ndryshme vizuale ndërmjet përdoruesit, arkitekturës së godinës dhe peizazhit të atriumit. Ndryshimet e kuotave, alternimi i sipërfaqeve të forta me ato të gjelbëruara dhe integrimi i elementeve ujore krijojnë një përvojë hapësinore dinamike, në të cilën hapësira zbulohet gradualisht gjatë lëvizjes. Në këtë mënyrë, relievi nuk perceptohet vetëm si një kusht fizik i sitit, por si një element aktiv i arkitekturës, që i jep identitet dhe karakter të gjithë sistemit.

5.2 Organizimi funksional i hapësirës

Zgjidhja arkitektonike organizon sistemin e jashtëm duke e trajtuar oborrin e brendshëm si atriumin e godinës, i cili përbën qendrën funksionale dhe hapësinore të saj. Organizimi mbështetet në konfigurimin ekzistues të terrenit dhe në marrëdhënien e drejtpërdrejtë me hyrjet dhe funksionet e objektit, duke krijuar një sistem të integruar qarkullimi, qëndrimi dhe aktiviteteve, të zhvilluar në nivele të ndryshme.

Atriumi strukturohet nëpërmjet një sistemi platformash që ndjekin relievin ekzistues dhe zbresin gradualisht drejt kuotës më të ulët të oborrit. Kjo mënyrë organizimi krijon një vazhdimësi natyrore të lëvizjes, duke lidhur të gjitha nivelet e sistemit dhe duke ofruar një përvojë hapësinore dinamike. Diferencat e kuotave nuk trajtohen si pengesë, por si mundësi për organizimin e funksioneve dhe për krijimin e një hierarkie të qartë të hapësirave.

Niveli më i lartë i atriumit është konceptuar si një hapësirë pritëse dhe orientues për kandidatët, duke shërbyer si zona e parë e kontaktit me oborrin dhe si element tranzicioni ndërmjet godinës dhe sistemit të jashtëm. Në vijim të tij, niveli i ndërmjetëm organizon hapësirat kryesore të qarkullimit dhe të qëndrimit, duke krijuar një tranzicion gradual drejt pjesës qendrore të atriumit dhe duke ofruar ambiente fleksibël për pushim, komunikim dhe ndërveprim. Niveli më i ulët përbën pikën, ku është vendosur hapësira multifunktionale e destinuar për zhvillimin e aktiviteteve institucionale, eventeve, prezantimeve dhe përdorimeve të tjera në ambient të




Figura 8 Zonimi

hapur. Të tre nivelet lidhen nëpërmjet sistemit të platformave, shkallëve dhe rampave, duke krijuar një organizim të vazhdueshëm hapësinor dhe funksional që garanton lidhje organike ndërmjet të gjitha pjesëve të atriumit.


Në tërësi, organizimi funksional synon ta transformojë atriumin në një hapësirë aktive dhe përfaqësuese të institucionit, ku arkitektura, relievi dhe aktivitetet e përdoruesve ndërveprojnë në mënyrë të harmonizuar, duke e bërë sistemin e jashtëm pjesë integrale të përvojës së godinës.

5.3 Parametrat kryesore teknike

Zgjidhja arkitektonike e atriumit është dimensionuar në funksion të karakteristikave morfologjike të sitit, kërkesave funksionale të objektit dhe standardeve të projektimit për

hapësirat publike të jashtme. Organizimi në nivele të ndryshme është zhvilluar me synimin për të siguruar një tranzicion gradual ndërmjet kuotave, duke ruajtur një ekuilibër ndërmjet cilësisë arkitektonike të hapësirës, komoditetit të përdorimit dhe realizueshmërisë së ndërhyrjes.

Modelimi i terrenit realizohet nëpërmjet një sistemi platformash të dimensionuara në përputhje me relievin ekzistues, ku diferencat e kuotave janë optimizuar për të kufizuar lartësinë e mureve mbajtëse dhe për të garantuar një organizim të qartë të qarkullimit. Shkallët janë projektuar me numër të kufizuar këmbësh në çdo segment, duke shmangur zhvillimin e shkallëve të gjata dhe duke krijuar ritëm të rregullt të lëvizjes ndërmjet platformave. Disnivele ndërmjet platformave është përcaktuar në funksion të konfigurimit të terrenit dhe organizimit të hapësirave, duke mundësuar një kalim natyror nga niveli i hyrjes drejt hapësirës multifunkionale në kuotën më të ulët të atriumit.



Numri maksimal i këmbëve në një segment shkalle	6
Disniveli maksimal ndërmjet dy platformave	105 cm
Gjerësia minimale e shkallëve	0.3 m
Sipërfaqja e hapësirës multifunktionale	190 m ²
Sipërfaqja e gjelbëruar	71 m ²
Sipërfaqja e shtruar	713.5 m ²
Sipërfaqja ujore	43 m ²

5.4 Hapësirat e qëndrimit dhe aktivitetit

Organizimi i atriumit është zhvilluar mbi parimin e krijimit të hapësirave me intensitete të ndryshme përdorimi, të cilat ndërthuren në mënyrë graduale përgjatë zhvillimit të niveleve. Në vend të një hapësire të vetme me funksion unik, projekti krijon një sistem ambientesh të lidhura ndërmjet tyre, ku secili nivel merr një rol të veçantë në organizimin e përgjithshëm të atriumit.

Niveli më i lartë është konceptuar si hapësirë pritjeje dhe orientimi për kandidatët, duke krijuar zonën e parë të kontaktit me atriumin dhe duke lehtësuar organizimin e flukseve në hyrje të institucionit. Në vijim të tij, nivelet e ndërmjetme zhvillohen si hapësira qëndrimi, komunikimi dhe vëzhgimi, të integruara me gjelbërimin, elementet ujore dhe mobilimin urban, duke krijuar ambiente të përshtatshme për pushim dhe ndërvëprim.

Në kuotën më të ulët të atriumit është organizuar hapësira multifunktionale, e projektuar për zhvillimin e aktiviteteve institucionale, eventeve, prezantimeve dhe formave të tjera të grumbullimit në ambient të hapur. Pozicionimi i saj në fund të sistemit të platformave e bën atë pikën kulmore të organizimit funksional të projektit dhe krijon një marrëdhënie të drejtpërdrejtë me të gjitha nivelet e atriumit.

Një rol të rëndësishëm në aktivizimin e hapësirës kanë edhe shkallët, të cilat janë konceptuar jo vetëm si elemente lidhëse ndërmjet niveleve, por edhe si ulëse gjatë zhvillimit të aktiviteteve në hapësirën multifunktionale, duke krijuar një konfigurim me karakter amfiteatral. Në të njëjtën kohë, gjelbërimi nuk shërben vetëm si element peizazhistik, por krijon zona pushimi dhe qëndrimi, përmirëson mikroklimën dhe kontribuon në cilësinë e përgjithshme të hapësirës.

Në tërësi, organizimi i këtyre funksioneve krijon një atrium aktiv dhe fleksibël, ku lëvizja, qëndrimi dhe aktivitetet zhvillohen në mënyrë të ndërthurur, duke i dhënë sistemit të jashtëm një rol të rëndësishëm në funksionimin e përditshëm dhe në përfaqësimin institucional të godinës.




Figura 10 Plani i ri i propozuar

5.5 Sistemi i qarkullimit dhe lidhjet vertikale

Sistemi i qarkullimit është konceptuar në funksion të organizimit hapësinor të atriumit dhe të modelimit arkitektonik të terrenit, duke krijuar një rrjet të qartë lëvizjeje ndërmjet niveleve të ndryshme të sistemit. Lidhjet vertikale realizohen nëpërmjet shkallëve të integruara në sistemin e platformave, të cilat sigurojnë vazhdimësinë e qarkullimit dhe forcojnë karakterin kompozicional të ndërhyrjes.

Përveç funksionit të tyre si elemente lidhëse, shkallët janë projektuar edhe si hapësira qëndrimi, duke marrë në zona të caktuara funksionin e ulëseve gjatë zhvillimit të aktiviteteve në hapësirën multifunktionale. Kjo zgjidhje krijon një konfigurim me karakter amfiteatral, i cili aktivizon atriumin dhe rrit fleksibilitetin e përdorimit të tij për evente dhe aktivitete në ambient të hapur.

Aksesueshmëria në nivelet kryesore të atriumit është zgjidhur nëpërmjet organizimit të hyrjeve ekzistuese të godinës. Niveli i sipërm aksesohet drejtpërdrejt nga recepsioni, ndërsa niveli më i ulët lidhet me pasazhin në kuotën përkatëse, duke mundësuar përdorimin e këtyre hapësirave edhe nga personat me aftësi të kufizuara, pa ndërhyrë në organizimin arkitektonik të atriumit.

Organizimi i qarkullimit respekton kërkesat për evakuimin e sigurt të godinës, duke garantuar që rrugët e evakuimit të mbeten të lira dhe funksionale në çdo kohë. Zgjidhjet e propozuara janë koordinuar me projektet përkatëse arkitektonike dhe të mbrojtjes nga zjarri, pa penguar funksionimin e daljeve të emergjencës dhe rrugëve të shpëtimit.

Në tërësi, sistemi i qarkullimit është zhvilluar si pjesë përbërëse e kompozimit arkitektonik, duke krijuar një lëvizje të qartë dhe intuitive përgjatë atriumit dhe duke forcuar marrëdhënien funksionale ndërmjet niveleve, hapësirave të aktivitetit dhe godinës.

6. Elementet arkitektonike dhe peizazhiste të sistemimit

Përzgjedhja e materialeve të plansistemimit mbështetet në krijimin e një gjuhe të unifikuar, bashkëkohore dhe të qëndrueshme, ku sipërfaqet e forta minerale ndërthuren në mënyrë të kontrolluar me elementet natyrore të ujit dhe gjelbërimit. Paleta e materialeve përbëhet nga pllaka guri, beton i larë me agregat të ekspozuar në dy tonalitete gri dhe gri e hapur, hapësira ujore, hapësira dhe rripa të gjelbër, si dhe kombinime të barit me pllaka guri. Diferencimi i materialeve dhe tonaliteteve lidhet drejtpërdrejt me funksionin e secilës zonë, duke evidentuar sipërfaqet kryesore të qarkullimit, zonat e qëndrimit, hapësirat e tranzicionit dhe elementet fokale të kompozimit, pa cenuar vazhdimësinë vizuale të tërësisë. Betoni i larë me agregat të ekspozuar krijon bazën kryesore të shtrimit dhe siguron një sipërfaqe rezistente dhe të përshtatshme për përdorim intensiv, ndërsa pllakat e gurit dhe kombinimi i tyre me barin krijojnë ritëm, ndryshim teksture dhe kalime më të buta drejt zonave të gjelbra. Hapësirat ujore dhe gjelbërimi integrohen në të njëjtën logjikë gjeometrike, duke sjellë kontrast, reflektim dhe një karakter më natyror në raport me sipërfaqet minerale. Ndryshimet e materialit, ngjyrës dhe



Figura 12 Materializimi

teksturës ndjekin gjeometrinë e projektit dhe ndihmojnë në leximin e drejtimeve të lëvizjes dhe organizimit të hapësirës. Njëkohësisht, materialet janë përzgjedhur duke marrë në konsideratë qëndrueshmërinë ndaj konsumimit dhe kushteve atmosferike, jetëgjatësinë dhe lehtësinë e mirëmbajtjes, me synim ruajtjen në kohë të cilësisë funksionale dhe karakterit estetik të plansistemimit.

Koncepti i gjelbërimit mbështetet në integrimin e bimësisë si element aktiv i kompozimit arkitektonik dhe peizazhistik, duke krijuar një marrëdhënie të drejtpërdrejtë ndërmjet ndërtesës, hapësirës së jashtme dhe elementeve natyrore. Gjelbërimi nuk trajtohet vetëm si plotësim dekorativ, por si një instrument për strukturimin e oborrit, orientimin e pamjeve, krijimin e zonave me hije dhe zbutjen e karakterit mineral të shtrimeve, shkallëve dhe platformave. Përzgjedhja e specieve *Magnolia grandiflora*, *Arbutus unedo* dhe *Gleditsia triacanthos* krijon strukturën vertikale të kompozimit dhe një ritëm të kontrolluar të kursorave, duke ofruar njëkohësisht hijezim dhe ndryshueshmëri sezonale. Në nivelin e ndërmjetëm, *Viburnum tinus* dhe *Teucrium fruticans* krijojnë volume më të ulëta dhe kompakte, ndërsa *Festuca glauca* formon një shtresë të imët pranë terrenit, duke realizuar kalimin gradual nga sipërfaqet e forta drejt zonave të gjelbra. Paleta kromatike është konceptuar në marrëdhënie me arkitekturën dhe materialitetin e ndërtesës: tonalitetet e ndryshme të së gjelbrës, nuancat gri- jeshile dhe argjendta të bimësisë së ulët krijojnë kontrast të kontrolluar me tonalitetet neutrale të shtrimit dhe fasadës, ndërsa gjelbërimi i errët dhe me shkëlqim i *Magnolia grandiflora* dhe *Viburnum tinus* krijon pika më të theksuara vizuale. Ndryshimet sezonale, lulëzimi dhe variacionet e teksturës i japin hapësirës një karakter dinamik gjatë gjithë vitit, pa cenuar qetësinë e kompozimit arkitektonik. Në raport me basenet ujore, platformat dhe shkallët, bimësia krijon kontrast ndërmjet sipërfaqeve të buta dhe atyre minerale, ndërsa reflektimi i gjelbërimit në ujë e zgjeron vizualisht praninë e tij në hapësirë. Në nivelin e përjetimit, alternimi ndërmjet zonave të hapura, sipërfaqeve të hijëzuara, gjelbërimit të dendur dhe elementeve ujore krijon një sekuençë të larmishme gjatë lëvizjes në oborr, duke e bërë



Figura 13 Gjelbërimi

hapësirën më të rehatshme, më të perceptueshme në shkallë njerëzore dhe më të lidhur me karakterin arkitektonik të ndërtesës.

Basenet ujore përbëjnë një nga elementet kryesore të kompozimit arkitektonik të plansistemimit, duke u integruar në gjeometrinë e sheshit dhe duke krijuar një kontrast të kontrolluar ndërmjet sipërfaqeve të forta, gjelbërimit dhe ujit. Prania e ujit sjell një dimension më dinamik dhe njëkohësisht qetësues në hapësirë, duke zbutur karakterin mineral të shtrimeve dhe duke përmirësuar perceptimin vizual të zonës. Sipërfaqet e qeta të ujit funksionojnë si plane reflektuese, duke pasqyruar qiellin, gjelbërimin dhe elementet arkitektonike përreth dhe duke krijuar një perceptim më të gjerë dhe më të thellë të hapësirës. Diferencat e kuotave ndërmjet baseneve shfrytëzohen për të krijuar kalime të kontrolluara të ujit dhe për të theksuar relievin dhe organizimin në nivele të plansistemimit, pa e kthyer elementin ujqor në një ndërhyrje dominuese. Basenet shërbejnë gjithashtu si elemente orientuese dhe fokale, duke organizuar vizualisht zonat e qëndrimit dhe lëvizjes dhe duke krijuar pika interesi përgjatë itinerareve të këmbësorëve. Integrimi i tyre me shkallët, platformat, shtrimin dhe gjelbërimin synon që uji të perceptohet si pjesë e vazhdueshme e arkitekturës së sheshit dhe jo si një element i shtuar, duke kontribuar në krijimin e një ambienti publik më tërheqës, të qetë dhe me identitet të dallueshëm.




Figura 14 Aksonometri

Mobilimi urban është konceptuar si pjesë integrale e plansistemimit, duke plotësuar organizimin funksional të hapësirës dhe duke ruajtur të njëjtën gjuhë bashkëkohore dhe minimaliste të projektit. Stolat, elementet e uljes, koshat, strukturat për parkimin e biçikletave dhe elementet e tjera të mobilimit pozicionohen në raport me drejtimet kryesore të lëvizjes, zonat e gjelbëruara dhe hapësirat ujore, duke krijuar pika qëndrimi dhe pushimi pa penguar qarkullimin e këmbësorëve. Përzgjedhja e formave të thjeshta, materialeve rezistente dhe tonaliteteve neutrale synon integrimin vizual të mobilimit me betonin, gurin dhe gjelbërimin e plansistemimit, duke shmangur elementet që konkurrojnë me kompozimin arkitektonik. Në

zona të caktuara, vetë konfigurimi i shkallëve, platformave dhe elementeve të betonit shfrytëzohet për të krijuar sipërfaqe uljeje, duke e bërë mobilimin pjesë të gjeometrisë së projektit. Vendosja e elementeve është menduar për të nxitur përdorimin aktiv të hapësirës, qëndrimin dhe ndërveprimin social, si dhe për të krijuar kushte më të përshtatshme për përdoruesit gjatë gjithë ditës. Materialet dhe sistemet e fiksimit përzgjidhen gjithashtu në funksion të qëndrueshmërisë duke garantuar jetëgjatësi, siguri dhe kërkesa të reduktuara për mirëmbajtje.



Figura 15 Render




Figura 16 Render

6 Përmbledhje

Projekti i plansistemimit paraqet një ndërhyrje të integruar arkitektonike dhe peizazhistike, e zhvilluar në përputhje me karakteristikat e terrenit ekzistues dhe me organizimin funksional të godinës. Nëpërmjet modelimit të relievit, krijimit të një sistemi të hierarkizuar platformash dhe organizimit të qartë të qarkullimit, hapësira transformohet në një mjedis funksional, të aksesueshëm dhe me identitet të qartë arkitektonik.

Koncepti i projektit ndërthur elementet e ndërtuara me gjelbërimin dhe sipërfaqet ujore, duke krijuar një kompozim të balancuar që përmirëson cilësinë hapësinore, kushtet mikroklimatike dhe përvojën e përdoruesit. Organizimi i zonave të qëndrimit, qarkullimit dhe aktiviteteve mundëson përdorim fleksibël të oborrit, ndërsa zgjidhjet e propozuara për mobilimin, ndriçimin, sinjalistikën dhe aksesueshmërinë kontribuojnë në funksionimin e tij të sigurt dhe efikas.

Përzgjedhja e materialeve me jetëgjatësi të lartë, integrimi i specieve bimore të përshtatura me klimën lokale dhe koordinimi me projektet e tjera inxhinierike garantojnë qëndrueshmërinë teknike dhe mjedisore të ndërhyrjes, si edhe lehtësinë e mirëmbajtjes në afatgjatë. Në tërësi, projekti krijon një hapësirë bashkëkohore, përfaqësuese dhe funksionale, e cila siguron vazhdimësi me konceptin arkitektonik të godinës dhe rrit cilësinë e mjedisit të jashtëm në aspektin estetik, social dhe funksional.

Figura 1 Pamje nga brenda.....	5
Figura 2 Terreni ekzistues i sistemimit.....	6
Figura 3 Gjendja ekzistuese.....	7
Figura 4 Gjelberimi ekzistues.....	8
Figura 5 Gjelberimi ekzistues.....	9
Figura 6 Plani i elementeve qe do te hiqen.....	13
Figura 7 Kompozimi i hapesires.....	13
Figura 8 Zonimi.....	16
Figura 9 Plani i elementeve te ndertuara	17
Figura 10 Plani i ri i propozuar.....	19
Figura 11 Aksesibiliteti	20
Figura 12 Materializimi.....	20
Figura 13 Gjelberimi	21
Figura 14 Aksonometri.....	22
Figura 15 Render.....	23
Figura 16 Render.....	23